

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Sot është një ditë ku secili prej jush e pa se sa ishte halli i madh i Edi Ramës, njëkohësisht dhe gëzimi i tij më i madh në aferën më të madhe që ka ndodhur që kur ekziston shteti shqiptar. Afera e portit të Durrësit bëri që Rama të ishte kloun, të ishte qesharak, të ishte një ndyraq, të ishte një njeri që me gojën e tij të poshtër dhe të ndyrë të përmendte cilindo jo vetëm nga opozita, por në 100 vjet cilindo që ai mendon se mund t'i ketë dalë kundër qoftë në media, qoftë në shoqërinë civile, qoftë ambasador, qoftë delegacionin e BE-së! U rrotullua në varr Faik beu, për krahasimin që bëri Kryeministri me të. Ju e dini, ashtu siç e di edhe ai, që krahasimi jo vetëm që nuk qëndron, por bëhet po ashtu nga një njeri, po e përsëris, që është një ndyraq, që ndyu parlamentin gjatë gjithë kohës kur foli.

Konica, pavarësisht kontributit të madh që i dha Shqipërisë, jetonte me pension shtetëror, ndërsa ky këtu pas, që tani ka ikur, jeton në luks të ndërtuar mbi vjedhjen dhe plaçkitjen e qytetarëve shqiptarë; ky këtu, ndërkohë që Konica jetonte me pension shtetëror, jeton në super vila të bëra në kurrizin e qytetarëve shqiptarë, në avion personal, që paguhet me taksat e qytetarëve shqiptarë, me miliona euro salltanete, veshje, makina, shërbime që dalin nga qytetarët shqiptarë.

Vepra e Konicës ishin librat, ishin gazetatat, ishin botimet, ndërsa veprat e këtij dhe të këtyre këtu pas janë PPP-të, kanabisi, droga, largimi i qytetarëve shqiptarë, ministrat që kanë përfunduar në burg për shkak të korrupsionit masiv, ndarja e Shqipërisë në plaçkë për 5 veta, siç edhe po ndodh sot me supraferën që e bëri Kryeministrin të ishte në raport me opozitën një fabrikë e përpunimit të helmit, pavarësisht se një burrë në moshë, me një staturë të caktuar, siç e patë, u bë ujë nga helmi, e mbyti helmi i vet, siç kishte helm ndaj opozitës. Nuk e përmbante dot. E panë qytetarët shqiptarë, e patë edhe ju gëzimin e brendshëm se po kalonte kjo marrëveshje, më në fund. I erdhi dita, ishte me hare, me këndime, me recitime, me fluturime dhe e kishte zellin, tamam siç e tha, si një gomaricë, që po shikonte përpara një gjë të madhe dhe po gëzohej, sepse kishte një plaçkë të madhe përpara.

I eksituar nga ajo që shihte, i zgurdullonte sytë, pëlliste me të madhe dhe i drejtohej kujtdo, që e shikonte si armik, duke mos u marrë në asnjë moment të vetëm me argumentin, por duke u marrë në personale me ata që ia nxirrnin përpara argumentet. E tha pak më parë kolegu parafolës që në Shqipëri

shumë gjëra lindin nga tavolinat. Po, këtë jemi duke thënë gjatë gjithë kohës, sepse, ndërkohë që ne përpiqemi t'ju japim argumentet në raport me çështjet në rrugë institucionale, edhe kjo aferë e madhe ka lindur nga një tavolinë, jo nga ajo e thashethemeve, siç thatë ju, por nga ajo e Nusretit, ku e gjithë qeveria nisi të negocionte dhe t'i ofronte Shqipërisë një investitor, i cili do të ketë emrin, siç duket nga kontrata, dhe të gjithë pjesën tjetër të investimit do ta kenë kompani offshore, që nuk dihet se ku i kanë lidhjet dhe nuk dihet se ku i kanë financimet.

Pra, zanafilla ishte ajo darkë e nisur shumë kohë më parë, aty është shitur porti i Durrësit. Strategjikisht cilido mund të bëjë një pyetje: nëse ky është një investitor kaq serioz dhe me këto të dhëna, ku Shqipëria ka investim strategjik, pse nuk bëhet kudo, në çdo pjesë tjetër të territorit të Republikës, qoftë në Durrës, qoftë në Jug, apo pak më poshtë, ashtu siç sollët disa letra pak më parë për portin e Karpenit, ku do të investoheshin 5 miliardë euro?! Sepse ky është i vetmi interes që kanë ndërtuesit, të cilët janë shqiptarë, dhe i keni parë sesi po i shesin si sekserë, Sude-Rama. Ky është rasti, ku do ta shikoni sesi Sude-Rama, së bashku me bashkëpunëtorët e vet, po shesin ajrin dhe tokën, ndërkohë që ende nuk ka filluar dhe ky parlament nuk e kaluar ende marrëveshjen. Kjo është situata në të cilën ndodhet.

Në kontratë e keni të shkruar që financimi i një prej burimeve do të jetë nga të ardhurat dhe nga shitjet e grumbulluara prej klientëve, shitje, të cilat kanë filluar pa kaluar kontrata në këtë parlament. Kjo është kompania serioze që ju u tregoni qytetarëve shqiptarë. Po ta marrim nga interesi publik. Çfarë fitojnë qytetarët shqiptarë nga kjo, sepse filloni e flisni për pazare: "Na thanë 9%, i thamë 12, por ai e çoi te 30%", dua t'ju them se toka nuk vlen 600 milionë euro, sepse 818318 metra katrorë vlejnë më shumë se 1 miliard euro me vlerën e sotme. Mjafton të shihni në një media, ku dje e kishin pyetur zyrën e shitjeve të kompanisë së Ramës për çmimin e tokës, ende pa u bërë, vetëm për tokë dhe ajër ata thoshin që është 1500 euro metri, ndërsa apartamentet dhe njësitë e shërbimit shumë më shumë.

Nëse kjo tokë do t'i jepej cilido biznesi shqiptar, do ta merrte me më shumë se 50%, sepse këtyre biznesmenëve po u japin prapë. Këta e kanë marrë nga shteti me këtë përqindje dhe po ua japin bizneseve të tjera ndërtuese në Shqipëri, këtu do të jemi dhe do t'ju themi edhe emrat, me 50%, madje, duke u kërkuar edhe 2 milionë euro cash për ata që janë në vijë të parë. Kjo po ndodh sot në Shqipëri. Ndërkohë që ne bëjmë sikur diskutojmë, ky mbrapa e ka ngritur dorën dhe këtu nuk ekziston asgjë tjetër, kontrata mes oligarkëve shqiptarë, që fshihen pas Alabarit, Ramës dhe ndërtuesve të tjerë në këtë vend, ka kaluar.

Pra, ju zotërinj, po falni 1 miliard euro pronë, ndërkohë po falni më shumë se 40792 metra katrorë nga detyrimi i kontributit për strehimin, që do të bënin më shumë se 60 milionë euro, nëse do të ishin vetëm njësi shërbimi; po i falni, pothuajse, 60 milionë euro të tjera nga taksa e ndikimit në infrastrukturë kompanisë së Ramës, sepse nuk bëhej ndryshe kjo dhe nuk ka investitorë strategjikë që hyjnë në këto të Sude-Ramës dhe po i humbni Shqipërisë 28 milionë euro sot. Ju e patë investimin për kalatat sesi Bashkimi Europian tha që tërhiqemi nga paratë që do të jepnin nga taksapaguesit europianë për qeverinë shqiptare dhe për qytetarët shqiptarë. Të gjithëve na ka ardhur një shkresë nga një kompani gjermane, nuk e kisha dëgjuar këtë kompani më parë, e cila thotë që po cenoni investimin gjerman. Pra, po cenoni investimet e biznesit gjerman, që do t'ju kushtojë 100-200 milionë euro të tjera dëm nëpër arbitrazhe.

Ndërkohë, sot u tha për herë të parë që porti i ri do të shkonte, pothuajse, në 400 milionë euro të tjera. Pra, me këtë port ekzistues ju po i vendosni qytetarëve shqiptarë, vetëm me këto që keni në kontratë, dy miliardë euro në kurriz si barrë dhe po ia jepni ato vetëm një kompanie, që, nëse nuk ka interesa fitimprurëse të Edi Ramës dhe bandës së tij, të hajdutëve me çizme... Jepni një shpjegim tjetër sesi mund të bëhet kjo, kur kjo nuk ka një logjikë ekonomike dhe logjikë strategjike, si mund të merret një port?! Këta thanë që nuk ka më kapacitet dhe pyeta ekspertët për këtë. Ata më thanë që porti është shumë më pak se kapaciteti që ka, prandaj po bëheshin edhe investimet në kalata nga Bashkimi Europian. Ju, përveç kësaj, doni një kosto tjetër, që nuk e thoni, dhe do ua ngarkoni qytetarëve shqiptarë.

Porti i ri do të shkojë më shumë se 400 milionë, por, ndërkohë, do t'i ngarkoni biznesit shqiptar, qytetarëve shqiptarë, qytetarëve të Kosovës, që keni bërë marrëveshje për portin e thatë të Prishtinës, edhe miliona euro, apo miliarda, nëse doni, të një kompanie që do t'ia jepni me koncesion për 30 e ca vjet të tjerë portin e Durrësit. Ku ka interes më personal se ky që bëni ju, për të shkatërruar një qytet të tërë?! Ju pyesni: "Pse portin në mes të qytetit?". Po ku keni parë ju ndonjë port historik që të mos jetë porti në qytet, në Selanik, në Tivar, në Xhenova, në Barcelonë? Të gjitha portet janë aty ku kanë qenë historikisht. Ju, atë që nuk e kanë bërë me luftë romakët, meqenëse e përdorët, do ta bëni me para. Ju nuk e bëni këtë me një kompani perëndimore, ky perëndimori i madh, por merr një kompani që vjen nga Lindja, merr një kompani që është e regjistruar offshore, merr një kompani që shet në hava pa kaluar ende në parlament, që, në fakt, kryen vepër penale.

Po të kishte institucione, të cilat ky i përmend, por që i ka kapur për gryke dhe përsëri ka korrupsion aq të madh sa djersitet dhe bëhet ujë, siç u bë sot, do të kishit shkuar aty dhe nuk do të diskutohet kjo sot,

por do të diskutohej abuzimi, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni, interesat kriminale dhe pastrimi i parave që po bëhet me një projekt thellësisht hajdutëror dhe korruptiv. Për këtë ne jo vetëm që jemi kundër, por do të jemi me qytetarët shqiptarë në çdo moment për të ndaluar çdo projekt korruptiv të këtyre përmasave.